



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 176

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 18 tetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 94/2024, datë 12.9.2024	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 1.8.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014, ‘Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë’” 20191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 638, datë 16.10.2024	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme të bashkërendimit të punës ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave..... 20191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 16.10.2024	Për përcaktimin e elementeve të akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative, që kontrollohen për efekt regjistrimi..... 20194
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 16.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 20197
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 16.10.2024	Për miratimin e rregullores për përzgjedhjen e kandidatit për zëvendës drejtor të përgjithshëm, drejtor të departamentit, drejtor të drejtorisë vendore dhe shef të komisariatit në Policinë e Shtetit..... 20198
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 16.10.2024	Për deklarimin pasuri kulturore të “Zonave arkeologjike ‘A’ dhe ‘B’” të qytetit të Elbasanit dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre..... 20206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 16.10.2024	Për deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës historike” të qytetit të Elbasanit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre..... 20211
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 16.10.2024	Për rregullat e detajuara për zhvillimin e programit të shitjes me të drejtë parablerjeje të objekteve të konfiskuara 20217
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 16.10.2024	Për procedurën dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it..... 20218

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 647, datë 16.10.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 26, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2024”	20219
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 16.10.2024	Për miratimin e procedurave dhe të kriterëve që ndiqen për financimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit që konsiderohen të rëndësishme të veçantë.....	20220
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 16.10.2024	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Cirkut Kombëtar.....	20222
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. (11-2024-2801) 823, datë 23.5.2024	Për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Bujar Aruçi....	20222
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. 882 (2998), datë 30.5.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Albin Roçi.....	20222
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. 881 (11-2024-3000), datë 30.5.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ylber Hoxha.....	20222
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nr. 1124 (11-2024-4210), datë 15.7.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Yllka Mema.....	20222
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Rebi Haxhiu.....	20222

**LIGJ**
Nr. 94/2024**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2,
DATË 1.8.2024, “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 123/2014,
‘PËR URDHRIN E MJEKËVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 1.8.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 123/2014, ‘Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë’”.

KRYETARE
Elisa Spiropali

Miraturar në datën 12.9.2024.

VENDIM
Nr. 638, datë 16.10.2024**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË HOLLËSISHME TË
BASHKËRENDIMIT TË PUNËS
NDËRMJET AGJENCISË SHTETËRORE
TË KADASTRËS DHE AGJENCISË SË
TRAJTIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 57, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme të bashkërendimit të

veprimtarisë administrative të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “ASHK”) dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave (në vijim “ATP”), për zbatimin e ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar.

2. ASHK-ja dhe ATP-ja janë të detyruara të përdorin informacionin, që shkëmbehet sipas mënyrave të përcaktuara në këtë vendim, dhe të bashkërendojnë veprimtarinë për:

a) trajtimin e kompensimit fizik të subjekteve, duke respektuar kriteret e legjislacionit për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, në zonat ku zbatohen proceset kalimtare;

b) evidentimin e pronave të paluajtshme të shtetit, përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, të kartelave dhe hartave kadastrale, në funksion të evidentimit të këtyre pronave;

c) verifikimin, përditësimin dhe regjistrimin e gjendjes juridike të fondit të tokës bujqësore, pyll, livadh, kullotë, i cili është në dispozicion të ATP-së në fondin fizik të kompensimit, sipas akteve nënligjore në fuqi;

ç) identifikimin e pronës së paluajtshme të shtetit, për kalimin e saj në fondin e kompensimit fizik të subjekteve të shpronësuar;

d) zëvendësimin e pasurive të fondit të kompensimit fizik në dispozicion të ATP-së, të cilat janë në posedim faktik të përfituesit të aktit të marrjes në pronësi të tokës bujqësore, që është në proces regjistrimi;

dh) përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për transferimin e vlerës monetare të pronës së shitur në fondin special të ATP-së;

e) përputhjen e elementeve hartografike të vendimeve përkatëse, sipas pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi;

ë) kalimin e pronësisë pa shpërblim të tokës bujqësore, sipas seksionit 3, të kreut II, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, proces për të cilin ATP-ja informon mbi sipërfaqet, objekt kërkesë të kompensimit fizik, si dhe për pasuritë, që janë pjesë e fondit të tokës.



II. RREGULLAT E HOLLËSISHME TË BASHKËRENDIMIT

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet ASHK-së dhe ATP-së, për efekt të procedurave administrative të të dyja institucioneve, kryhet nëpërmjet përdorimit të moduleve digjitale për shkëmbimin e informacionit, të miratuar me aktet ligjore e nënligjore përkatëse në fuqi.

2. Përjashtimisht, shkëmbimi i informacionit në rrugë shkresore ose nëpërmjet postës elektronike do të kryhet vetëm në rastet e mëposhtme:

a) Kur për shkak të problemeve informatike/infrastrukturore, deri në tejkalimin e tyre, ndërveprimi i bazave të të dhënave apo funksionimi i moduleve digjitale është përkohësisht i pamundur;

b) Për informacionin mbi proceset kalimtare të pronësisë, deri në ngritjen e bazës së të dhënave të këtyre proceseve dhe digjitalizimin e informacionit;

c) Kur informacioni që është ofruar paraprakisht në mënyrë digjitale nuk është i plotë apo kur është i nevojshëm interpretimi i tij.

3. Për të miratuar kompensimin fizik në bazë të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, ATP-ja duhet të mbështetet në informacionin kadastral dhe në informacionin për proceset kalimtare të pronësisë, sipas neneve 12 e 24, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar, si dhe neneve 36, shkronja “c”, e 58, pika 1, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”.

4. ATP-ja nuk mund të vendosë për kompensimin fizik të subjekteve të shpronësuara, për pasuritë që janë objekt i proceseve kalimtare të pronësisë. Përjashtim bën rasti, kur kemi të bëjmë me kërkesa për kalimin e pronësisë pa shpërblim të tokës bujqësore. Verifikimi i informacionit në funksion të procedurës së kompensimit fizik kryhet nga ATP-ja, sipas rregullave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të kreut II, të këtij vendimi.

5. Në çdo rast, dokumentacioni hartografik, që shoqëron kërkesën për informacion mbi gjendjen juridike të pronës dhe vendimin e ATP-së për kompensim fizik, duhet të përmbushë standardet teknike të përcaktuara në legjislacionin për organizimin e funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor. Ai duhet të jetë në përputhje me shkallën dhe kornizën

hartografike të ASHK-së, duke pasqyruar koordinatat e pasurisë së paluajtshme.

6. Për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, që disponojnë për kompensimin e pronarëve joposedues mbi truallin e zënë nga ndërtimet pa leje, kryhen procedurat e mëposhtme:

a) Në momentin e legalizimit të ndërtimit dhe të regjistrimit të tij, në kartelën e pasurisë së parcelës ndërtimore, në seksionin “Informacione të tjera”, vendoset shënimi, që tregon se pasuria, ose një pjesë e saj do t’i nënshtrohet kompensimit. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, në kartelën e pasurisë duhet të pasqyrohet vendimi i kompensimit për pronarin joposedues dhe kalimi i pronësisë sipas nenit 22, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”;

b) ATP-ja, përpara se të ekzekutojë pagesën për kompensimin e pronarit joposedues, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, duhet t’i kërkojë ASHK-së konfirmimin e gjendjes juridike, pjesët takuese të bashkëpronarëve, informacionin, nëse pasuria është e lirë nga çdo barrë apo detyrim, që mund të jetë vendosur mbi pronën që është tjetërsuar gjatë procesit të legalizimit.

7. ATP-ja e dërgon në rrugë elektronike kërkesën për informacion mbi gjendjen juridike të pasurisë, e cila duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar. Pas paraqitjes së kërkesës në formën e kërkuar nga ligji, ATP-ja njofton subjektin e interesuar që ka iniciuar procedurën administrative pranë saj për shlyerjen e tarifës për marrjen e shërbimit kadastral të kërkuar. Pas shlyerjes së pagesës, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 389, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, të ndryshuar, drejtoria vendore e ASHK-së, sipas afateve të miratuara me aktet nënligjore në fuqi, jep informacion mbi gjendjen juridike të pronës dhe pjesët takuese të pronarëve, që do të kompensohen sipas informacionit e dokumentacionit të administruar në regjistrat kadastralë.

8. Kur ATP-ja merr vendim për kompensim fizik të pronarit, ky vendim duhet t’i njoftohet ASHK-së, në zbatim të vendimit nr. 223, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen



e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar.

Njoftimi zyrtar i shoqëruar me vendimin i përcillet ASHK-së jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e miratimit, me qëllim që të pasqyrohet në kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

9. Fondi i tokës, për qëllim kompensimi, i nënshtrohet përditësimit, në zbatim të nenit 58, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

10. Procedura për përditësimin e fondit të tokës realizohet, si më poshtë vijon:

a) Pasi e identifikon, ASHK-ja e njofton ATP-në për pasurinë, pjesë të fondit, që është objekt i proceseve kalimtare të pronësisë. Ajo pozicionon grafikisht në hartën kadastrale pjesën e sipërfaqes, që hiqet nga fondi dhe informon ATP-në për të dhënat e pasurive të mbetura si rezultat i kalimit të pronësisë nga ASHK-ja për efekt të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”.

b) ASHK-ja, me kërkesë të ATP-së, identifikon një pasuri që do të zëvendësojë atë që hiqet nga fondi, me të njëjtën sipërfaqe dhe, mundësisht, në të njëjtën zonë kadastrale. Nëse kjo është e pamundur, zgjidhet një pasuri që ka vlerë ekuivalente, e përcaktuar kjo sipas hartës së vlerës në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar.

c) ASHK-ja kryen procedurat e hartimit të projektaktit për ndryshimet në vendimin nr. 770, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23368,8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësive të qeverisjes vendore”.

ç) Njëkohësisht, ASHK-ja, për sipërfaqen përkatëse të propozuar për t’u hequr nga fondi i tokës, e cila është objekt i procesit kalimtar të kalimit të pronësisë sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, heq shënimet e vendosura në regjistrat kadastralë të pasurisë mbi informacionin për kompensimin fizik të ATP-së dhe vijon me procedurat administrative të regjistrimit të titujve të pronësisë të lëshuar në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e

Shqipërisë”, dhe ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

d) Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për zëvendësimin e pasurisë në fondin e tokës, ASHK-ja bën regjistrimin e këtij akti në regjistrat kadastralë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

dh) ATP-ja akseson bazën e të dhënave të ASHK-së për të verifikuar nëse prona që do të shërbejë për kompensim fizik është në pronësi të shtetit e nuk u shërben proceseve kalimtare apo nuk ka asnjë pretendim nga të tretët.

III. BASHKËRENDIMI PËR TOKËN BUJQËSORE

1. Procedura për kalimin në fondin e tokës të sipërfaqeve sipas pikës 10, të kreut II, këtij vendimi, realizohet nga ASHK-ja dy herë në vit, pasi të kryhet procesi i evidentimit të tyre, nga drejtoritë vendore, sipas zonave kadastrale, gjatë regjistrimit fillestar apo përmirësim-përditësimit. ASHK-ja përgatit propozimin e miratimit nga Këshilli i Ministrave të kalimit të sipërfaqeve në fondin e tokës.

2. Toka bujqësore, që është pjesë e fondit të kompensimit, miratuar me vendimin nr. 770, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në fondin e kompensimit fizik në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësive të qeverisjes vendore”, që u është dhënë subjekteve me akt të marrjes së tokës në pronësi, me vendim gjykatë të formës së prerë apo me një akt tjetër, në përputhje me parashikimet e nenit 193 të Kodit Civil, e që kërkohet të regjistrohet, do të zëvendësohet dhe do të hiqet nga ky fond, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 10, të kreut II, të këtij vendimi.

3. Për verifikimin e kushteve për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ASHK-ja kërkon informacion pranë ATP-së në një nga format e parashikuara në këtë vendim, në përputhje me parashikimet e nenit 68, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, të ndryshuar.



IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për të realizuar regjistrimin në regjistrin kadastral të fondit pyjor, kullosor në administrim të ATP-së, sipas vendimit nr. 1077, datë 18.6.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor”, dhe të pikës 68/2, të vendimit nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin, në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar, ATP-ja paraqet kërkesën për shërbimin kadastral, “Regjistrim të kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ”, për pasuritë konkrete të individualizuara, sipas zonave kadastrale, shoqëruar nga dokumentacioni hartografik, ku identifikohet pasuria. Ky shërbim nuk i nënshtrohet kamatëvonesës.

2. Tarifa për regjistrim sipas pikës 1, të kreut IV, të këtij vendimi, i kompensohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nga fondet e buxhetit të shtetit, në përputhje me pikën 3, të nenit 63, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Nëse vlera nuk rimbursohet në vitin pasardhës, drejtoria vendore e ASHK-së nuk vijon me dhënien e shërbimit.

3. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 639, datë 16.10.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
TË AKTEVE NOTERIALE, VENDIMEVE
GYJQËSORE APO AKTEVE
ADMINISTRATIVE, QË
KONTROLLOHEN PËR EFEKT
REGJISTRIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton të gjitha elementet e akteve noteriale, vendimeve gjyqësore, akteve administrative dhe akteve të përmbaruesit gjyqësor, që Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK) duhet të kontrollojë për efekt të regjistrimit të tyre në regjistrin kadastral.

2. Përveç përjashtimeve të përcaktuara me ligj, ndryshimi i gjendjes juridike të pasurisë së paluajtshme në regjistrin kadastral bëhet vetëm nëse veprimi i fundit që do të kryhet në regjistrë vjen si rrjedhojë e titullit të regjistruar të pronarit paraardhës për pasurinë e paluajtshme të certifikuar.

3. Kur aktet noteriale, vendimet gjyqësore, aktet administrative dhe aktet e përmbaruesit gjyqësor nuk përmbajnë elementet formale, të përcaktuara në këtë vendim, në bazë të nenit 26, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës njofton kërkuesin për plotësimin e të metave, sipas afatit të përcaktuar në këtë dispozitë. Kur kërkuesi nuk plotëson të metat brenda afatit, kërkesa refuzohet nga ASHK-ja.

II. KONTROLLI I ELEMENTEVE TË AKTEVE NOTERIALE

1. Aktet noteriale, që përmbajnë kalimin ose njohjen e së drejtës së pronësisë apo e një të drejte reale mbi një pasuri të paluajtshme, me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, i nënshtrohen kontrollit të elementeve të formës nga ASHK-ja, si më poshtë vijon:

a) Elementet e formës, në përputhje me ligjin nr. 110/2018, “Për noterinë”, neni 99 e vijues, dhe, sipas rastit, me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse;

b) Objektin e aktit noterial, që duhet të tregojë vendndodhjen, numrin e pasurisë, zonën kadastrale, sipërfaqen, llojin e pasurisë, kufijtë sipas hartës kadastrale apo dokumentacionin teknik, bashkëlidhur aktit noterial dhe, sipas rastit, vlerën e pasurisë së paluajtshme;

c) Deklarimin e noterit se ka verifikuar pronësinë e palës në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme, duke i bashkëlidhur aktit, së bashku me certifikatën e pronësisë, edhe kopje të kartelës kadastrale dhe hartës kadastrale të rifreskuar.

2. Për aktet noteriale që disponojnë për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, krahas elementeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, kontrollohet edhe që akti të përmbajë:



a) çmimin e pasurisë dhe mënyrën e pagesës së tij;

b) deklarimin e regjimit pasuror martesor, sipas parashikimeve të Kodit të Familjes.

Në rastet kur pasuria është fituar përgjatë martesës dhe bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor, duhet cilësuar shprehimisht në aktin noterial prezumimi i bashkësisë ligjore.

3. Për aktet e trashëgimisë, të çelura nga noteri, verifikohen elementet e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu.

Për efekt të procedurave të regjistrimit të akteve të trashëgimisë, në rastet kur pasuritë janë të regjistruara në pronësi të trashëgimlënësit, ASHK-ja gjatë procesit të regjistrimit të aktit të trashëgimisë duhet të verifikojë nëse pasuritë kanë qenë në pronësi individuale të trashëgimlënësit apo me prezumimin e bashkësisë ligjore.

ASHK-ja verifikon nëse në aktin e trashëgimisë është zbatuar parashikimi i bërë në pikën 2, të nenit 112, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

4. Me kontrollin, sipas përcaktimeve të pikave 1–3, të këtij kreu, për të kryer regjistrimin mbi pasurinë e paluajtshme për të cilën disponon akti, ASHK-ja verifikon nëse:

a) pasuria e paluajtshme figuron në regjistrin kadastral, në emër të tjetërsuesit/tjetërsuesve/transferuesit të së drejtës, sipas aktit noterial; dhe

b) të dhënat e pasurisë së paluajtshme, sipas përmbajtjes së aktit noterial, përputhen me të dhënat e pasqyruara në regjistrin kadastral.

III. KONTROLI I ELEMENTEVE TË VENDIMEVE GJYQËSORE

1. Vendimet gjyqësore që përmbajnë fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e së drejtës së pronësisë ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike, ose aktet e tjera për kalimin e pronësisë, të regjistruara më parë, me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, i nënshtrohen kontrollit të elementeve të formës dhe përmbajtjes nga ASHK-ja, nëse:

a) vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë, sipas parashikimeve të nenit 451, të Kodit të Procedurës Civile;

b) të paktën njëra nga palët ndërgjyqëse (ose trashëgimtarët e saj, sipas neneve 165 e 316, të Kodit të Procedurës Civile) figuron në regjistrat kadastrale, pronare e pasurisë së paluajtshme, mbi të cilën gjykata ka disponuar me vendim (nenet 18 dhe 90 të Kodit të Procedurës Civile); dhe

c) në dispozitivin e vendimit, të dhënat për pasurinë e paluajtshme janë të plota dhe lejojnë regjistrimin e saj ose regjistrimin e të drejtave të tjera reale mbi të, si dhe përputhen me të dhënat e pasqyruara në regjistrin kadastral; dhe

ç) ekzistojnë regjistrime pronësie në favor të personave të tjerë fizikë ose juridikë, që nuk kanë qenë palë ndërgjyqëse në gjykim mbi pasurinë e paluajtshme për të cilën disponon vendimi.

Nëse pasuria e paluajtshme, mbi të cilën gjykata ka disponuar sipas vendimit, figuron pronë shtetërore ose në emër të një institucioni apo enti publik, procedohet duke verifikuar nëse ka qenë palë në gjykim pikërisht ai institucion ose ent publik, që ka pasur të drejtën e pronësisë mbi pasurinë (nenet 18 dhe 90 të Kodit të Procedurës Civile), dhe Avokatura e Shtetit (neni 79/a i Kodit të Procedurës Civile dhe disponimet e ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar);

d) në gjykimet, që kanë për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave/Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Agjencisë së Trajtimit të Pronave është thirrur si palë ndërgjyqëse në gjykim pronari (apo trashëgimtarët e tij), në emër të të cilit figuron prona e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme (nenet 18 e 90 të Kodit të Procedurës Civile);

dh) në gjykim, me objekt kundërshtimin e procedurave apo të kontratës së shitjes së pasurive publike/shtetërore, të kryera nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit/Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike/Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike në ministrinë përgjegjëse për administrimin e pronës publike, është thirrur si palë në gjykim apo palë e interesuar institucioni apo enti publik, që ka të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme dhe/ose Avokatura e Shtetit.

2. Vendimet për regjistrimin e hipotekës gjyqësore duhet të përmbajnë gjithashtu edhe vlerën e detyrimit që garantohet nga hipoteka gjyqësore.

3. Vendimet gjyqësore, të dhëna për sigurimin e padisë, si dhe ato për ekzekutimin e përkohshëm regjistruhen edhe pse nuk kanë marrë formë të prerë sepse nuk shkaktojnë fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë.



4. Në vendimet gjyqësore, që kanë objekt kundërshtimin e akteve administrative, të krijuara nga organet kompetente, fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, verifikohet, gjithashtu, nëse palët në gjykim, pronari (trashëgimtarët) i pasurisë së paluajtshme, institucioni/enti publik që ka nxjerrë aktin ose që ka në administrim pasurinë mbi të cilën ka disponuar gjykata dhe palë pjesëmarrëse Avokatura e Shtetit, përputhen me të dhënat e regjistruara në regjistrat kadastrale.

IV. KONTROLLI I ELEMENTEVE TË AKTEVE ADMINISTRATIVE DHE AKTEVE TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR

1. Aktet administrative, që përmbajnë kalimin e së drejtës së pronësisë/reale mbi një pasuri të paluajtshme, me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, i nënshtrohen kontrollit të elementeve të formës nga ASHK-ja, si më poshtë vijon:

a) elementet e formës, në përputhje me përcaktimet e kreut VI, të Kodit të Procedurave Administrative, dhe të ligjeve apo akteve nënligjore përkatëse, që rregullojnë regjimin e tyre;

b) të dhënat e pasurisë së paluajtshme, vendndodhja, numri i pasurisë, zona kadastrale, sipërfaqja, pozicioni gjeografik, kufijtë e saktë, pronari/bashkëpronarët përfitues nga akti administrativ dhe, sipas rastit, vlerën e pasurisë së paluajtshme;

c) paraqitja grafike e pasurisë së paluajtshme për të cilën disponon akti administrativ;

ç) ekzistenca e regjistrimeve të mundshme të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, që është objekt i kërkesës për regjistrim, në favor të personave të tjerë, fizikë ose juridike, përveç palëve të përcaktuara në aktin administrativ, të cilat nuk kanë qenë palë në procesin administrativ;

d) nëse në aktin administrativ të dhënat për pronën janë të plota dhe lejojnë regjistrimin e saj në regjistrat kadastrale;

dh) nëse kanë përfunduar afatet ligjore për ankimin administrativ.

2. Përjashtimisht, për regjistrimin e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi (AMTP), si akt administrativ, ASHK-ja kryen procedurat e verifikimit të elementeve dhe të regjistrimit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, që miraton procedurat e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, saktësimin e kufijve, sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese.

3. Aktet e përmbaruesit gjyqësor që përmbajnë kalimin e së drejtës së pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me paraqitjen e kërkesës për regjistrim, i nënshtrohen kontrollit të elementeve të formës nga ASHK-ja, si më poshtë vijon:

a) elementet e formës së aktit përmbarimor, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, dhe në ligjin nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror”;

b) objekti i aktit përmbarimor, që duhet të tregojë vendndodhjen, numrin e pasurisë, zonën kadastrale, sipërfaqen, pozicionin gjeografik, kufijtë e saktë dhe, sipas rastit, vlerën e pasurisë së paluajtshme;

c) deklarimi i përmbaruesit se ka verifikuar pronësinë e palës në regjistrin e pasurive të paluajtshme, duke i bashkëlidhur aktit kopje të kartelës kadastrale të rifreskuar të pasurisë;

ç) nëse të dhënat e pasurisë së paluajtshme në regjistrin kadastral përputhen me të dhënat, sipas aktit të përmbaruesit;

d) nëse në aktin e përmbaruesit të dhënat e pasurisë janë të plota dhe lejojnë regjistrimin;

dh) ekzistenca e regjistrimeve të mundshme të pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, që është objekt i kërkesës për regjistrim, në favor të personave të tjerë, fizikë ose juridike, përveç palëve të përcaktuara në aktin e përmbaruesit.

V. REFUZIMI I REGJISTRIMIT TË AKTEVE NOTERIALE, VENDIMEVE GJYQËSORE APO AKTEVE ADMINISTRATIVE NË REGJISTRAT KADASTRALE

1. Kërkesat për regjistrimin e akteve noteriale, vendimeve gjyqësore apo akteve administrative do t'i nënshtrohen refuzimit, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 24 dhe 26 e vijues, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, në rastet e mëposhtme:

a) kur vendimi gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë, në përputhje me disponimet e bëra në nenin 510, të Kodit të Procedurës Civile;

b) kur në pjesën urdhëruese të vendimit (dispozitivit) të gjykatës përcaktohet se është vendosur vërtetimi i faktit juridik të pronësisë, sipas nenit 388, të Kodit të Procedurës Civile, përveç rasteve të dhënies së vendimit para datës së hyrjes në fuqi të Kodit Civil (1 nëntor 1994), nëse nuk krijon mbivendosje me tituj të tjerë të regjistruar;

c) kur të dhënat për pasurinë nuk janë të plota e nuk janë të përcaktuara, sipas përcaktimeve të bëra në kreun II – IV, të këtij vendimi;



ç) kur në aktet noteriale nuk janë plotësuar elementet e formës, sipas përcaktimeve të bëra në kreun II, të këtij vendimi;

d) kur në aktet administrative nuk kanë përfunduar afatet ligjore për ankimimin administrativ/nuk plotësohen elementet e formës sipas përcaktimeve të bëra në kreun IV, të këtij vendimi/ekzistojnë regjistrime të pronësisë për pasurinë e paluajtshme në favor të personave të tjerë fizikë/juridikë;

dh) kur në bazë të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, aktet e paraqitura për regjistrim nuk kanë vijueshmëri kronologjike me pasurinë e regjistruar dhe që do të krijonte mbivendosje të titujve.

2. Kur subjektet e përmendura në shkronjat: “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të kreut III, të këtij vendimi, nuk janë thirrur si palë në gjykim, kërkesa për regjistrim pezullohet dhe për pasurinë e paluajtshme, që përbën objektin e saj, titullari i ASHK-së lëshon urdhër për kufizimin në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, sipas nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Në këtë rast, titullari i ASHK-së merr masat për njoftimin e këtyre subjekteve, në përputhje me dispozitat e ligjit të sipërpërmendur. Në momentin e mbarimit të afatit të kufizimit mbi pasurinë e paluajtshme, ASHK-ja vlerëson rastin dhe konkludon me procedurën e regjistrimit ose refuzimit të tij, sipas rastit.

3. Kur vendoset kufizimi i kërkesës për regjistrim, sipas pikës 2, të këtij kreu, titullari i ASHK-së është i detyruar që kopjen e plotë të praktikës t’ua dërgojë, me shkresë përcjellëse, institucionit apo entit publik (kur ky është i identifikuar) dhe Avokaturës së Shtetit. Korrespondenca e mbajtur me institucionet ose entet publike dhe Avokaturën e Shtetit, sipas rastit, i bashkëlidhen dosjes së praktikës.

4. Kur në bazë të pikës 1, të këtij kreu, propozohet refuzimi i kërkesës apo kufizimi i regjistrimit, dosja e plotë e praktikës, së bashku me projektvendimin e refuzimit i kalojnë për kompetencë drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Me miratimin e vendimit/urdhrit, kërkuar i vihen në dispozicion kopja e njëzuar e dokumentacionit të dosjes dhe udhëzimi për të drejtën, afatet e ankimit, organet kompetente për shqyrtimin gjyqësor të ankimit, si

dhe orientimi për mënyrën e saktë të plotësimit të shkaqeve të refuzimit.

VI. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Kur akti noterial, vendimi gjyqësor, akti administrativ apo vendimet e përmbaruesit gjyqësor disponojnë për një pasuri të paluajtshme, e cila ndodhet në një zonë kadastrale pa regjistrim fillestar, regjistrimi i aktit kryhet sipas nenit 19, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”. Në këtë rast ASHK-ja kontrollon vetëm elementet e akteve dhe vërtetësinë e regjistrimit ekzistues, kur për pasurinë është depozituar më parë dokumentacion për regjistrim dhe po kryhet një veprim tjetërsimi.

2. Kërkesat e paraqitura për regjistrim përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për të cilat nuk ka përfunduar trajtimi administrativ, i nënshtrohen parashikimeve të këtij vendimi.

3. Udhëzimi nr. 2, datë 12.9.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 640, datë 16.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHKETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të



ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) shkronja “e”, e pikës 12, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Punonjësve në pozicionin “shofer autoambulance” në institucionet shëndetësore të shërbimit spitalor dhe paraspitalor, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.”;

b) në numrin rendor 1, të kreut I/8, “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve qendrore”, shtohet emërtesa “shofer autoambulance në institucionet shëndetësore në nivel qendror të shërbimit spitalor dhe paraspitalor, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe në Spitalin Universitar të Traumës”;

c) në numrin rendor 2, të kreut II/1, “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, dhe të disa institucioneve të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”, shtohet emërtesa “shofer autoambulance në spitalet rajonale/bashkiake dhe qendrat shëndetësore të kujdesit parësor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar i ministrive përgjegjëse dhe nga fondet e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2024.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 641, datë 16.10.2024**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT
PËR ZËVENDËSDREJTOR TË
PËRGJITHSHËM, DREJTOR TË
DEPARTAMENTIT, DREJTOR TË
DREJTORISË VENDORE DHE SHEF
TË KOMISARIATIT NË POLICINË
E SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 59, të pikës 5, të nenit 60, të pikës 5, të nenit 61, dhe të pikës 4, të nenit 62, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për përzgjedhjen e kandidatit për zëvendësdrejtore të përgjithshëm, drejtor të departamentit, drejtor të drejtorisë vendore dhe shef të komisariatit në Policinë e Shtetit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në rregulloren e Policisë së Shtetit, miratuar me vendimin nr. 750, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dispozitat që parashikojnë përzgjedhjen e kandidatit për zëvendësdrejtore të përgjithshëm, drejtor të departamentit, drejtor të drejtorisë vendore dhe shef të komisariatit në Policinë e Shtetit, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për ndjekjen, dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

KREU I
TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Parime të përgjithshme

Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes bazohet dhe respekton parimin e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit.



Neni 2 Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim garantimin e zhvillimit të një procesi vlerësimi objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës, të nxisë konkurrencën profesionale dhe drejtuese në përzgjedhjen e kandidatëve që shfaqin aftësi dhe rezultate të larta, integritet moral dhe profesional.

KREU II KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT, MËNYRA E VLERËSIMIT

Neni 3 Zëvendës drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Ka të drejtë të aplikojë për funksionin “Zëvendës drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit” punonjësi i policisë, i cili plotëson kriteret e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, si më poshtë:

1. Më së paku, mban njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues;
2. Të ketë shtetësi shqiptare;
3. Të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Të mos ketë marrë masat disiplinore të përcaktuara më poshtë, brenda 5 (pesë) vjetëve të fundit:
 - a) ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;
 - b) shtyrje e afatit të gradimit deri në 5 vjet;
 - c) ulje me një gradë për një periudhë deri në 5 vjet;
5. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
6. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

Neni 4 Drejtor departamenti

Ka të drejtë të aplikojë për funksionin “Drejtor i departamentit” punonjësi i policisë, i cili plotëson

kriteret e pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, si më poshtë:

1. Të mbajë njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues;
2. Të ketë shtetësi shqiptare;
3. Të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 (tre) vjetëve të fundit;
5. Të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
6. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

Neni 5 Drejtor i drejtorisë vendore

Ka të drejtë të aplikojë për funksionin “Drejtor i drejtorisë vendore” punonjësi i policisë, i cili plotëson kriteret e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, si më poshtë:

1. Të mbajë njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues;
2. Të ketë shtetësi shqiptare;
3. Të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 (tre) vjetëve të fundit;
5. Të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
6. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

Neni 6 Shef komisarati

Ka të drejtë të aplikojë për funksionin “Shef komisarati” punonjësi i policisë, i cili plotëson kriteret e pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, si më poshtë:

1. Të mbajë njërën nga gradat e rolit të parë drejtues;
2. Të ketë shtetësi shqiptare;
3. Të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore të policisë brenda 3 (tre) vjetëve të fundit;
4. Të jetë në kushte shëndetësore, që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;



5. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.

Neni 7

Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, sipas rastit, shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionet: zëvendësdyrëtor të përgjithshëm, dyrëtor të departamentit, dyrëtor të dyrëtorisë vendore dhe shef të komisariatit në Policinë e Shtetit, e cila qëndron e hapur për 7 ditë.

2. Në thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit përcaktohen:

- a) funksioni për konkurrim;
- b) koha, vendi dhe mënyra e aplikimit;
- c) kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët;
- ç) dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët;
- d) fazat që kalojnë kandidatët deri në përfundim të procesit;
- dh) forma dhe përmbajtja e formularit të vlerësimit;
- e) mënyra e komunikimit me kandidatët në çdo fazë të procesit.

3. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit publikohet në faqen zyrtare të Dyrytorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Neni 8

Shprehja e interesit nga kandidatët

1. Kandidatët plotësojnë dhe dorëzojnë pranë Komisionit për Vlerësimin e Aplikimeve (në vijim KVA) një kërkesë me shkrim, ku shprehin interesin, si dhe dokumentacionin provues për të dëshmuar kualifikimet e tyre për pozicionin përkatës.

2. Kandidati duhet të paraqesë një aplikim të plotë, në mënyrë që të merret në konsideratë. Vlerësimi bëhet vetëm mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara.

3. Kërkesa me shkrim shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- a) një jetëshkrim i përditësuar;
- b) një platformë personale e qëllimeve dhe objektivave që kandidati propozon të ndjekë. Ky dokument duhet të jetë punë origjinale e kandidatit dhe nuk duhet të kalojë 15 faqe;

c) vetëdeklarimin, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, emëruar ose që marrin funksione publike”;

ç) vërtetimin të gjendjes gjyqësore, lëshuar nga organi kompetent shtetëror, i lëshuar jo më herët se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

d) vërtetimin/dokumentacionin e përshtatshëm, që provon përvojën e punës së kandidatit për pozicionin për të cilin konkurron;

dh) vlerësimet profesionale dhe etike të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, apo rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit dhe sigurisë;

e) dokumentacionin e përshtatshëm që provon arritjet gjatë studimeve të larta dhe në trajnime, dhe kurse të certifikuara, brenda dhe jashtë vendit;

ë) dokumentacionin e përshtatshëm, që provon rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë;

f) kopje të dëshmive të gjuhëve të huaja, nëse ka;

g) kopje të gradës shkencore ose titujve akademikë, nëse ka;

gj) dokumentin shëndetësor që dëshmon aftësinë për punë, e lëshuar jo më herët se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

h) vetëdeklarim që kandidati nuk është në konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;

i) vetëdeklarim që kandidati nuk është larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe që nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

j) autorizimin për Komisionin e Vlerësimit të Aplikimeve, të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shprehja e interesit dhe të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në adresën e shënuar në thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit.

5. Pas përfundimit të afatit 7-ditor për paraqitjen e shprehjes së interesit, Dyrytoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit publikon në faqen zyrtare emrat e kandidatëve.



KREU III

PËRBËRJA E KOMISIONEVE TË
VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE DHE
KOMISIONEVE TË SHQYRTIMIT TË
ANKESAVE

Neni 9

**Përbërja e komisioneve të vlerësimit
të aplikimeve**

1. Komisioni për vlerësimin e aplikimeve për përzgjedhjen e kandidatit për zëvendës drejtor të përgjithshëm dhe drejtor të departamentit në Policinë e Shtetit përbëhet nga:

- a) një përfaqësues nga Ministria e Brendshme i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, kryetar;
- b) një përfaqësues nga Policia e Shtetit me gradën Drejtues i Parë, anëtar;
- c) një përfaqësues nga Akademia e Sigurisë me gradën Drejtues i Parë, anëtar.

2. Titullarët e institucioneve, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përcaktojnë anëtarët brenda 24 orëve nga shpallja e thirrjes.

3. Anëtarët e KVA-së për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të drejtorisë vendore dhe shef të komisariatit në Policinë e Shtetit përbëhet nga 3 përfaqësues të Policisë së Shtetit, të cilët mbajnë gradë/funksion më të lartë se funksioni për të cilin konkurrohet.

4. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit cakton anëtarët e KVA-së, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, brenda 24 orëve nga shpallja e thirrjes.

5. Nëse anëtari i KVA-së ka pengesa ligjore në kuptim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, zëvendësohet nga një anëtar tjetër.

6. KVA-ja asistohet nga sekretariati teknik, me përfaqësues nga Policia e Shtetit.

Neni 10

Komisioni i shqyrtimit të ankesave

1. Komisioni i shqyrtimit të ankesave (në vijim KSHA) për përzgjedhjen e kandidatit për zëvendës drejtor të përgjithshëm, drejtor të departamentit, drejtor të drejtorisë vendore dhe shef të komisariatit në Policinë e Shtetit përbëhet nga:

a) një përfaqësues nga Ministria e Brendshme, të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, kryetar;

b) një përfaqësues nga Policia e Shtetit, me gradën Drejtues i Parë, anëtar;

c) një përfaqësues nga Akademia e Sigurisë, me gradën Drejtues i Parë, anëtar.

2. Titullarët e institucioneve, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përcaktojnë anëtarët brenda 24 orëve nga shpallja e thirrjes.

3. Nëse anëtari i komisionit ka pengesa ligjore, në kuptim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, zëvendësohet nga një anëtar tjetër.

4. Komisioni asistohet nga sekretaria teknike.

KREU IV

FAZAT DHE PROCEDURAT E
VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Neni 11

Vlerësimi paraprak

1. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjeve të interesit, KVA-ja kryen vlerësimin paraprak të aplikimeve, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore.

2. Nëse është e nevojshme, pa kaluar afatin e parashikuar në këtë pikë, KVA-ja kërkon informacione të mëtejshme prej kandidatit, institucioneve publike apo punëdhënësit të kandidatit.

3. Në përfundim të vlerësimit paraprak, KVA-ja harton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe të kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kushte, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati dhe dokumentacionin shtesë të mbledhur.

4. KVA-ja merr vendim për skualifikimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe i njofton me shkrim kandidatët, në mënyrë të posaçme dhe të arsyetuar për shkaqet e skualifikimit.

5. Vendimet për kualifikimin ose skualifikimin e aplikantëve merren me shumicën e votave.

Neni 12

Intervistimi i kandidatëve

1. KVA-ja organizon intervistën me kandidatët dhe i njofton ata të paktën 48 orë përpara për datën dhe orën e intervistës.



2. Anëtarët e komisionit i drejtojnë pyetje kandidatit në përputhje me kriteret e vlerësimit, sipas këtij vendimi.

3. Seanca e intervistës për secilin kandidat mbahet në praninë e të gjithë anëtarëve të komisionit.

4. Intervista do të fokusohet në fushat e vlerësimit të kandidatit.

5. Pas përfundimit të intervistës, KVA-ja zhvillon një seancë të mbyllur për të vlerësuar cilësitë e secilit kandidat. Komisioni do të shqyrtojë çdo dokument të nevojshëm për vlerësimin e kandidatit.

Neni 13

Vlerësimi i kandidatëve

1. Kandidatët e kualifikuar vlerësohen për:

a) aftësitë profesionale, me peshë specifike 20% të vlerësimit të përgjithshëm;

b) integritetin moral, me peshë specifike 10% të vlerësimit të përgjithshëm;

c) aftësitë organizative dhe drejtuese, me peshë specifike 60% të vlerësimit të përgjithshëm;

ç) elementet shtesë për vlerësim, me peshë specifike 10% të vlerësimit të përgjithshëm.

2. Komisioni bën vlerësimin e kandidatëve sipas formularit të vlerësimit, të përcaktuar në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 14

Vlerësimi i aftësive profesionale

Vlerësimi i aftësive profesionale të çdo kandidati bazohet në kriteret e mëposhtme:

1. Kohëzgjatja dhe përshtatshmëria e përvojës në punë me funksionin për të cilin konkurron;

2. Rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në funksionet e mëparshme, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit ose sigurisë;

3. Rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe në kurse trajnimi të certifikuara, brenda dhe jashtë Shqipërisë;

4. Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë;

5. Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore (përveç atyre që

kanë shërbyer për fitimin e gradës shkencore), pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e rendit ose sigurisë.

Neni 15

Vlerësimi i integritetit moral

1. Vlerësimi i çdo kandidati në lidhje me integritetin moral bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional, bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe llogaridhënia;

b) Opinioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij, bazuar në cilësitë morale, si: besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, veprimtaritë sociale ose kulturore.

2. Vlerësimi për integritetin moral bëhet përmes dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët, dokumenteve të mbledhura nga komisioni, të dhënave nga seancat dëgjimore, të dhënave publike ose burimeve të tjera të besueshme.

Neni 16

Vlerësimi i aftësive organizative dhe drejtuese

1. Vlerësimi i çdo kandidati për aftësitë organizative dhe drejtuese bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

b) aftësitë në komunikim;

c) aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore;

ç) aftësia për përfaqësim në publik.

2. Komisioni vlerëson përmbushjen e kriterëve të mësipërme, bazuar në dokumentet e dorëzuara nga kandidati, të administruara nga komisioni, si dhe ato të mbledhura gjatë intervistimit në seancën dëgjimore me kandidatin.



Neni 17

Elemente shtesë për vlerësim

Krahas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, kandidatët vlerësohen edhe për kriteret e mëposhtme, si:

- a) mbajtja e titujve akademikë;
- b) studimet dhe trajnimet afatgjata të kryera jashtë vendit, jo më pak se dy javë në fushën e rendit ose sigurisë, ose aftësive menaxheriale;
- c) zotërimi i gjuhëve të huaja, të vërtetuar me dokument përkatës.

Neni 18

Procedura e vlerësimit

1. KVA-ja do të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar nga kandidati, të mbledhur nga KVA-ja dhe informacionin e dhënë gjatë intervistës për të përfunduar vlerësimin.

2. Secili nga anëtarët e KVA-së bën vlerësimin e kandidatëve me pikë, sipas rubrikave të përcaktuara në formularin e vlerësimit.

3. Anëtarët e komisionit bëjnë vlerësime individuale dhe të pavarura, dhe rezultati i kandidatit është mesatarja e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve të komisionit.

Neni 19

Shpallja e rezultateve paraprake

1. Brenda 48 orëve nga përfundimi i procesit të vlerësimit të kandidatëve, komisioni shpall listën e rezultateve përfundimtare të kandidatëve, sipas rendit zbritës.

2. Në rastet kur kandidatët kanë pikë të barabarta, renditet i pari kandidati i cili është vlerësuar më tepër për komponentin, i cili ka peshën specifike më të madhe, të përcaktuar në nenin 13, të këtij vendimi. Nëse edhe pas rivlerësimit kandidatët renditen me pikë të barabarta, ata do të listohen në bazë të vjetërsisë në funksion dhe në përvojën profesionale.

3. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për shkeljet procedurale të pretenduara, brenda 2 ditëve nga shpallja e rezultateve paraprake.

Neni 20

Procedura e ankimit

1. Vendimi për vlerësimin apo skualifikimin e kandidatit mund të ankimohet nga kandidati pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave, brenda 2 ditëve nga momenti i njoftimit.

2. KSHA-ja vendos brenda 5 ditëve nga momenti i paraqitjes së ankesës dhe njofton KVA-në, dhe kandidatin lidhur me vendimmarjen.

3. Mënyra e rivlerësimit pranë KSHA-së është sipas rregullave të parashikuara për KVA-në.

KREU V

SHPALLJA E REZULTATEVE DHE EMËRIMI NË DETYRË

Neni 21

Shpallja e rezultateve përfundimtare

1. Në përfundim të procesit të ankimit, KVA-ja, jo më vonë se dita e nesërme pas marrjes së vendimit për shqyrtimin e ankimit të fundit, publikon në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit listën e kandidatëve, të renditur sipas rezultatit të arritur në rend zbritës. Rezultati përfundimtar përlogaritet me dy presje dhjetore.

2. Në rastet kur kandidatët kanë pikë të barabarta, renditet i pari kandidati i cili është vlerësuar me pikë më tepër për komponentin, i cili ka peshën specifike më të madhe, të përcaktuar në nenin 13, të këtij vendimi. Nëse edhe pas rivlerësimit kandidatët renditen me pikë të barabarta, ata do të listohen në bazë të vjetërsisë në funksion dhe në përvojën profesionale.

Neni 22

Propozimi dhe emërimi në detyrë

1. Në përfundim të procesit të konkurrimit për funksionet “Zëvendësdyrëtor i përgjithshëm” dhe “Dyrtor departamenti”, dyrtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit i propozon ministrit të Brendshëm 3 (tre) kandidatë, të vlerësuar me pikët më të larta.

2. Në përfundim të procesit të konkurrimit për funksionet “Dyrtor i dyrtorisë vendore të Policisë” dhe “Shef komisarjati”, KVA-ja i vendos në dispozicion dyrtorit të përgjithshëm të Policisë listën përfundimtare të rezultateve, i cili duhet të



emërojë një nga 3 (tre) kandidatët me pikët më të larta.

3. Në çdo rast të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, asnjë kandidat nuk mund të emërohet në detyrë nëse nuk është vlerësuar me të paktën 70% të pikëve të rezultatit të përgjithshëm.

4. Autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, brenda 5 ditëve nga paraqitja e propozimit, emërojnë kandidatin fitues në funksionin përkatës. Dokumentacioni i kandidatit fitues, si dhe formularët e vlerësimit bëhen pjesë e dosjes së tij të personelit.

Neni 23

Konfidencialiteti, mbrojtja e të dhënave dhe klasifikimi

Procedurat e parashikuara në këtë vendim kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar. Dokumentet duhet të jenë të redaktuara para publikimit, në rast se përmbajnë informacion personal të kandidatëve ose informacion rreth personave të tjerë.

Lidhja nr. 1

AUTORIZIM MBI VERIFIKIMIN E FIGURËS DHE INTEGRITETIT

Unë i/e nënshkruari/a (emri, atësia, mbiemri), kandidat/e për zëvendës drejtor të përgjithshëm/ drejtor të departamentit/drejtor të drejtorisë vendore/shef të komisarit, autorizoj Komisionin e Vlerësimit të Aplikimeve të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të figurës dhe integritetit tim, si dhe çdo shkak tjetër përjashtues.

Ky autorizim ka vlerë deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna, të kryera nga Ministria e Brendshme apo persona/subjekte të autorizuar prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Autorizuesi

Data, vendi i nënshkrimit

Emër, mbiemër, nënshkrim

Lidhja nr. 2

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E KANDIDATIT

Kandidati/ja z./znj. _____

Nr.	Komponentët dhe elementet e vlerësimit	Pikët maksimale	Pikët e akorduara	
			Për çdo element	Për komponentin
1	Vlerësimi profesional	20	X	
	Kohëzgjatja dhe rëndësia/përshtatshmëria e eksperiencës në punë me pozicionin në të cilin konkurron			
	Rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit ose sigurisë			
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve të tyre të larta, si dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë.			
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë			
	Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e rendit ose sigurisë			



2	Vlerësimi moral dhe i integritetit	10	X	
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, llogaridhënia			
	Opinionin që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale, si: besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, veprimtaritë sociale ose kulturore			
3	Vlerësimi organizativ dhe drejtues	60	X	
	Cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin			
	Aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar, gjithashtu, në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore			
	Aftësitë në komunikim			
	Aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore			
	Aftësia për përfaqësim në publik			
4	Elemente shtesë për vlerësim	10	X	
	Mbajtja e titujve akademikë			
	Studime dhe trajnime afatgjata të kryera jashtë vendit, jo më pak se dy javë në fushën e rendit ose sigurisë, ose menaxheriale			
	Zotërimi i gjuhëve të huaja, duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës			
	TOTALI I PIKËVE	100		

Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve

Emri Mbiemri



VENDIM
Nr. 643, datë 16.10.2024

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE
TË “ZONAVE ARKEOLOGJIKE ‘A’ DHE
‘B’” TË QYTETIT TË ELBASANIT DHE
MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN,
MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN
E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të nënndarjes “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, dhe të pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore të “Zonave arkeologjike ‘A’ dhe ‘B’” të qytetit të Elbasanit, sipas hartës së zonifikimit dhe koordinatave gjeografike, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi në hartat kadastrale, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, dhe aktet nënligjore në zbatim.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartat e qendrës historike dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Vendimi nr. 687, datë 23.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e zonës arkeologjike ‘A’ të qytetit të Elbasanit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E ZONAVE
ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË
QYTETIT TË ELBASANIT

Neni 1
Qëllimi

1. Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Elbasanit, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Objektivat kryesorë të këtij plani janë:

a) ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe të peizazhit të zonave arkeologjike “A” dhe “B”;

b) administrimi i zonave arkeologjike “A” dhe “B”;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve të specializuara, të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Elbasanit, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 2

Hapësira urbane arkeologjike në mbrojtje

1. Hapësira urbane me vlera arkeologjike, historike dhe kulturore e qytetit të Elbasanit, pjesë e trashëgimisë kulturore, përbëhet nga:

a) zona arkeologjike “A”;

b) zona arkeologjike “B”.

2. Kufijtë e zonave arkeologjike “A” dhe “B” paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Elbasanit, shoqëruar me koordinatat në sistemin referues gjeodezik zyrtar – KRGJSH, pjesë përbërëse e këtij plani.

3. Plan i përgjithshëm vendor i qytetit të Elbasanit merr parasysh kufijtë e zonifikimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Elbasanit, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.



Neni 3

Ndërhryrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”

1. Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Elbasanit lejohet vetëm:

a) mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim KKTKM);

b) kryerja e formave të testimit, të tilla, si: sondazhe arkeologjike, që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, sondazhe për kontrollin e themeleve, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;

c) zbatimi i projekteve kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;

ç) rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

d) rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese pa ndryshim të gjurmës dhe pa kat nëntokë, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

dh) vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore, si dhe nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin;

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe, për çdo rast, duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës;

iii. vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.

2. Projektet, lidhur me ndërhryrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”, të qytetit të Elbasanit, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe më pas vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Neni 4

Ndërhryrjet e lejuara në zonën arkeologjike “B”

1. Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Elbasanit, përveç ndërhryrjeve që lejohen në zonën arkeologjike “A”, lejohen edhe ndërtimet e reja, pas miratimit nga KKTKM-ja.

2. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja dhe vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes të formave të testimit të përcaktuara nga KKTKM-ja, në varësi të potencialit arkeologjik që përfaqëson zona.

4. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast, njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Neni 5

Procedurat që ndiqen për ndërhryrjet e lejuara në zonat arkeologjike

1. Për ndërhryrjet e lejuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Elbasanit, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit.

Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKTK).

4. Për ndërhryrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 3, në varësi të shkallës së ndërhryrjeve dhe nevojës për rikonstruksion/rindërtim, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen:



a) format e testimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara;

b) monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

6. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e godinave ekzistuese, brenda zonave arkeologjike “A” dhe “B” të Elbasanit, duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrës historike të qytetit të Elbasanit dhe zonës mbrojtëse përreth, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Procedura që ndiqet në rast ndërhyrjesh të paaautorizuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Elbasanit

1. Në rast konstatimi ndërhyrjesh të paaautorizuara brenda zonave arkeologjike “A” dhe “B”, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, ka detyrimin të ndërpresë menjëherë veprimtarinë e subjektit, nëpërmjet aktit të konstatimit.

2. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, njofton menjëherë IKTK-në, institucionin kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionin kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, si dhe strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

3. Në rast se subjekti nuk ndërpret veprimet brenda 24 orëve, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, i drejtohet menjëherë institucionit kompetent për inspektim në fushën e trashëgimisë kulturore dhe/ose institucionit kompetent për inspektim të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, për marrjen e masave përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

4. Në çdo rast, ndërtimet pa leje në këto zona trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe me vendimin nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”.

Neni 7

Gjetjet rastësore arkeologjike

1. Në rast gjetjesh rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve në zonat arkeologjike, punimet pezullohen menjëherë, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 145, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Në varësi të vlerave që përmbajnë gjetjet rastësore arkeologjike, KKTKM-ja shprehet për procedurën dhe hulumtimet arkeologjike të nevojshme për ruajtjen e mbrojtjen e tyre.

3. Për çdo rast, veprimtaria arkeologjike realizohet sipas parashikimeve të neneve 139, 145, 146, 147, 260, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 8

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonat arkeologjike “A” dhe “B” lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.


3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre, dëshmime dhe gjetjeve arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së, përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, pas lajmërimit zyrtar nga Bashkia e Elbasanit.

4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 9

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë plan, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, nëpërmjet institucioneve të specializuara.





**KOORDINATAT E ZONIFIKIMIT ARKEOLOGJIK
“A” TË ELBASANIT**

ZONA ARKEOLOGJIKE A		
Nr.	X	Y
1	506708.9672	4553039.1040
2	506691.6927	4553091.3139
3	506561.8491	4553403.8757
4	506904.9146	4553539.6280
5	507050.0981	4553170.4665
6	506886.8881	4553103.8771
7	506914.2421	4553038.2837
8	506961.1392	4552964.9740
9	506867.0591	4552928.9554
10	506842.0824	4552994.9731
11	506832.0713	4553002.4018
12	506797.5307	4553071.4860

**KOORDINATAT E ZONIFIKIMIT ARKEOLOGJIK
ZONA “B” E ELBASANIT**

ZONA ARKEOLOGJIKE “B”		
Nr.	X	Y
1	506559.9147	4553406.76028
2	506844.0486	4553515.50449
3	506904.9146	4553539.62803
4	507050.0981	4553170.46650
5	507110.0742	4553014.00378
6	506960.1572	4552957.56596
7	506930.2359	4552942.72400
8	506916.3598	4552721.57276
9	506954.0521	4552721.20320
10	506992.3978	4552652.39457
11	506955.7412	4552617.56444
12	507011.4868	4552511.27023
13	506923.9758	4552479.42980
14	506903.3024	4552481.83943
15	506901.0706	4552537.92766
16	506878.7973	4552541.37768
17	506794.6315	4552540.94116
18	506743.7671	4552504.43929
19	506729.7964	4552482.11135
20	506701.6694	4552482.45028
21	506700.9514	4552516.18974
22	506684.9930	4552551.73946
23	506677.2632	4552591.02307
24	506681.6316	4552638.98170
25	506611.1853	4552642.40824



26	506619.8494	4552671.62333
27	506626.3842	4552701.87274
28	506645.5736	4552736.50239
29	506674.7470	4552777.59913
30	506688.2034	4552857.22050
31	506677.6451	4552877.74497
32	506701.0470	4553052.70755
33	506628.5056	4553232.13606
34	506570.6024	4553377.78826

VENDIM**Nr. 644, datë 16.10.2024**

**PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE
TË “QENDRËS HISTORIKE” TË
QYTETIT TË ELBASANIT,
PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE
TË SAJ DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR
RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës historike” të qytetit të Elbasanit, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të “Qendrës historike” të qytetit të Elbasanit, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të publikojë hartat e “Qendrës historike” të qytetit të Elbasanit dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**PLANI
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE
ADMINISTRIMIN E QENDRËS
HISTORIKE TË ELBASANIT DHE
ZONËS MBROJTËSE PËRRETH SAJ**

Neni 1**Qëllimi dhe objektivat**

Ky plan ka për qëllim miratimin e rregullave, të procedurave të autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e qendrës historike në qytetin e Elbasanit, zonës mbrojtëse përreth saj, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre.

Neni 2**Objekti**

Objekt kryesor i këtij plani janë:

a) ruajtja, mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike, arkeologjike dhe të peizazhit të qendrës historike të qytetit të Elbasanit dhe zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur;

b) administrimi i qendrës historike dhe i zonës mbrojtëse të saj;

c) mënyrat e bashkëpunimit të institucioneve e specializuara, të ngarkuara për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe miradministrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit të Elbasanit, me njësitë e vetëqeverisjes vendore.



Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane me vlera urbanistike, arkitektonike, historike, arkeologjike dhe të peizazhit e qytetit të Elbasanit, pjesë e trashëgimisë kulturore, përbëhet nga:

- a) qendra historike;
- b) zona mbrojtëse përreth saj.

2. Brenda zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen hapësira urbane brenda Kalasë së Elbasanit dhe zona mbrojtëse përreth, që përfshin rrugën “Janaq Kilica” në perëndim, rrugën “Ptoleme Xhuvani” në veri, rrugën “Rinia” në lindje dhe parku “Aqif Pasha” deri në rrugën “11 Nëntori” në jug, ku përfshihen Bazilika Paleokristiane dhe Muzeu Etnografik i qytetit.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Elbasan merr parasysh kufijtë e zonifikimit të qendrës historike dhe zonës mbrojtëse përreth saj në qytetin e Elbasanit, si dhe rregullat për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “Qendrës historike”, zonës mbrojtëse përreth saj, si dhe të monumenteve të kulturës, brenda kësaj hapësire.

Neni 4

“Qendra historike” dhe kufijtë e saj

1. “Qendra historike” e qytetit të Elbasanit është hapësira me vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike, arkeologjike dhe të peizazhit.

2. Hapësira urbane e “Qendrës historike” të Elbasanit përfshin hapësirën e Kalasë së Elbasanit, brenda të cilës ndodhen pasuri kulturore, monumente kulture të kategorisë I (banesa vernakulare dhe objekte kulturi) dhe objekte pa status.

3. Kufijtë e qendrës historike paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH të “Qendrës historike” paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5

Zona mbrojtëse e qendrës historike dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse është hapësira që shtrihet përreth “Qendrës historike” dhe përfshin dhe rrugët që konturojnë Kalanë e Elbasanit në perëndim, veri dhe lindje, ndërsa në jug përfshin edhe parkun “Aqif Pasha” deri në rrugën “11 Nëntori”.

2. Brenda kufijve të kësaj zone gjenden pasuri kulturore me rëndësi të veçantë, si dhe hapësira e bazilikës paleokristiane. Zona mbrojtëse e “Qendrës historike” me vlerën e saj mundëson kalimin nga qendra historike për tek hapësira e lirë urbane e qytetit.

3. Në zonën mbrojtëse ndodhen pasuri kulturore të paluajtshme, si monumente kulture të kategorisë I dhe objekte pa status.

4. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

5. Koordinatat në sistemin referues zyrtar-KRGJSH të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në qendrën historike

1. Ndërhyrjet në “Qendrën historike” kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike, arkeologjike dhe të peizazhit të qytetit të Elbasanit.

2. Brenda kësaj zone lejohen:

a) ndërhyrje sistematike të mirëmbajtjes, restauruese dhe konservuese;

b) ndërhyrje restauruese, që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitekturore të rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke përfshirë të gjitha kanalizimet e vjetra të zbuluara ose që do të zbulohen, si dhe duke ruajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave dhe shesheve publike;

c) rikonstruksione/rindërtime të ndërtesave mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik original, duke u bazuar në materiale arkivore dhe fotografike, pa cenuar vlerat e nëntokës;

ç) studime rehabilitimi të pjesëve të veçanta të qendrës historike, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe me formulimin e



tyre arkitekturor, cenojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të qendrës. Studimet përcaktojnë objektet, ku kryhen punime konservuese, restauruese dhe rikonstruksione, objektet për ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, si dhe objektet që cenojnë unitetin arkitekturor të zonës dhe vlerat e nëntokës;

d) ritrajtimet dhe rikonstruksionet, të cilat duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të qendrës historike, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

Neni 7

Ndërhryrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “Qendrës historike”

1. Ndërhryrjet e lejuara brenda zonës mbrojtëse janë:

a) restaurime, rikonstruksione dhe rindërtime të ndërtesave ekzistuese;

b) rikonstruksione dhe ndërtime të reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore;

c) ndërtime të reja, shtesa dhe përshtatje në sheshe të lira, në harmoni me karakteristikat e “Qendrës historike” dhe, bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Elbasan.

Neni 8

Ndërhryrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhryrjet në monumentet e kulturës, të cilat ndodhen brenda “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse përreth saj kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave, për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Brenda këtyre zonave lejohen:

a) ndërhryrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes;

b) rjetëzime, me kusht që projekti i rjetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Neni 9

Ndërhryrjet e ndaluara në tërësinë e “Qendrës historike” dhe të zonës mbrojtëse të saj

1. Në hapësirën e “Qendrës historike” dhe të zonës mbrojtëse të saj nuk lejohen ndërtimet e reja që prekin monumentet e kulturës dhe zonat mbrojtëse të tyre.

2. Në zonën mbrojtëse të “Qendrës historike” nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.

3. Në çdo rast, ndërtimet pa leje në këto zona trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimin nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, të ndryshuar.

Neni 10

Kriteret e projektimit për ndërhryrjet e lejuara në “Qendrën historike”, monumentet e kulturës dhe zonat mbrojtëse të tyre

1. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin në “Qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit apo të monumentit, për të cilët janë shpallur pasuri kulturore, si dhe në kriteret për konservim dhe restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim, legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin e objekteve ekzistuese brenda qendrës historike hartohen, bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik dhe grafik;

b) duke respektuar raportet urbanistike e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin original të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumnin



ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë, duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për ritrajtimet dhe përshtatjet brenda qendrës historike për të rritur vlerat e saj, hartohen, bazuar në studimet e kryera në pjesë të veçanta dhe në përputhje me kriteret e parashikuara në aktet nënligjore për zonën arkeologjike të qytetit të Elbasanit:

a) duke respektuar karakteristikat tradicionale të zonës, elementet origjinale arkitektonike dhe tipologjitë ndërtimore;

b) duke respektuar kushtin që lartësia e ritrajtimeve dhe e përshtatjeve nuk duhet të kalojë lartësinë e tri kateve;

c) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dymve dhe dritareve, si dhe ngjyrën e fasadës së banesës/objektit, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

ç) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çatave të reja, në rastet e mbulesave me çati, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.

4. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese, ndërtime të reja dhe shtesa brenda zonës mbrojtëse të qendrës historike hartohen, bazuar planit të detajuar vendor të Bashkisë Elbasan apo studimeve urbanistike e arkitektonike.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore, brenda zonës mbrojtëse të qendrës historike hartohen:

a) bazuar parashikimeve të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Elbasan;

b) duke mos cenuar vlerat e nëntokës dhe të objekteve ekzistuese në mbrojtje;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në “Qendrën historike”, monumentet e kulturës të veçanta dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Studimet për vlerësimin e ndërhyrjeve konservuese dhe restauruese në “Qendrën historike” dhe në zonën mbrojtëse të saj, duke përfshirë banesat, fasadat e tyre, muret rrethuese, kalldrëmet tradicionale dhe elemente të tjera urbanistiko-arkitektonike të monumenteve të kulturës hartohen nga Instituti Kombëtar i

Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), që ka në përgjegjësi administrimi qytetin e Elbasanit ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja, që ka në përgjegjësi administrimi qytetin e Elbasanit ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

2. Projektet për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen në “Qendrën historike” dhe monumentet e kulturës hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për Elbasanin, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM-ja. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja, përgjegjëse për qytetin e Elbasanit ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe rehabilitimin e hapësirave në “Qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, që ka në përgjegjësi administrimi Elbasanin ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM-ja. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara për zbatim në fushën e restaurimit. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionet, ndërtimet e reja dhe shtesa në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh, sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM-ja. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori, sipas ligjit për



planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja Korçë.

5. Projektet për rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe shesheve në “Qendrën historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja që ka në përgjegjësi administrimi qytetin e Elbasanit, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim në fushën e restaurimit dhe projektet për realizimin e linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore hartohen nga persona të licencuar, sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM-ja. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja, që ka në përgjegjësi administrimi Elbasanit ose subjekte të licencuara për zbatim në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve kryhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

6. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM-ja. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. DRTK-ja, që ka në përgjegjësi administrimi Elbasanit, monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

7. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimit e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në qendrën historike dhe monumentet e kulturës shqyrtohen nga IKTK-ja, DRTK-ja që ka në përgjegjësi administrimi qytetin e Elbasanit dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Në rastet kur projekti parashikon ndërhyrje në pasuritë kulturore, hartimi bëhet nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas

vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja, që ka në përgjegjësi administrimi qytetin e Elbasanit.

8. Projektet për ndërtimet e reja, shtesat dhe përshtatjet në sheshe të lira në zonën mbrojtëse hartohen nga subjekte të licencuara për këtë kategori projektesh, sipas ligjit të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe për zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

Neni 12

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në qendrën historike lejohet vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, pas shqyrtimit e miratimit nga KKTKM-ja.

2. Në asnjë rast, tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo të konkurrojnë monumentet, dëshmitë dhe gjetjet arkeologjike.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre, dëshmimeve dhe gjetjet arkeologjike bëhet nën mbikëqyrjen e DRTK-së përgjegjëse për qytetin e Elbasanit, pas lajmërimit zyrtar nga Bashkia Elbasan.


4. Është e ndaluar vendosja e posterave apo e mjeteve të tjera reklamuese, si dhe dëmtimet e tjera (vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme) të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike.

Neni 13

Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Këtij plani i bashkëngjitet zonifikimi i “Qendrës historike” i zonës mbrojtëse dhe tabelat përkatëse të koordinatave të saj.



ANEKSI 1
QENDRA HISTORIKE

Nr.	Koordinata	Koordinata
1	507030.320373316	4553175.91155594
2	506715.218971064	4553050.71802137
3	506573.354033958	4553405.4189096
4	506898.598325487	4553533.64389476
5	507030.320373316	4553175.91155594



ANEKSI 2
ZONA MBROJTËSE

Nr.	Koordinata	Koordinata
1	507110.074196756	4553014.00378221
2	506960.157155873	4552957.56596015
3	506688.203440072	4552857.22049899
4	506665.721694364	4552888.70539518
5	506700.437301988	4553058.44917216
6	506592.564057625	4553324.2585525
7	506558.245524549	4553407.54001791
8	506905.496953499	4553541.70673443
9	507110.074196756	4553014.00378221

VENDIM

Nr. 645, datë 16.10.2024

**PËR RREGULLAT E DETAJUARA PËR
ZHVILLIMIN E PROGRAMIT TË
SHITJES ME TË DREJTË PARABLERJEJE
TË OBJEKTEVE TË KONFISKUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9, të nenit 20, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara, si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave të detajuara për zhvillimin e programit të shitjes me të drejtë parablerjeje të objekteve të konfiskuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

2. Procesi i shitjes realizohet duke respektuar parimin e ligjshmërisë, të konkurrencës, të transparencës, si dhe të zbutjes së pasojave sociale të shkaktuara nga ndërtimet pa leje apo në tejkalim të lejes së ndërtimit.

3. Procedura e shitjes së objekteve të konfiskuara fillon pas miratimit nga Komisioni i Objekteve të

Konfiskuara (në vijim “Komisioni”) të programit të shitjes, i cili, së bashku me dokumentacionin shoqërues, përcillet pranë ministrit të përgjegjës për administrimin e pronës.

4. Struktura përgjegjëse për privatizimin në ministrinë përgjegjëse të administrimit të pronës shtetërore aplikon pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit apo pranë çdo institucioni të qeverisjes vendore apo lokale, sipas parashikimeve të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 66/2023, “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara” (në vijim “ligji nr. 66/2023”).

5. Pas përfundimit të aplikimeve dhe të plotësimit të dokumentacionit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, përcaktohet vlera e objektit me ekspertë vlerësues të licencuar të pasurisë së paluajtshme, të caktuar nga ministri përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore në urdhrin e vlerësimit të objektit të konfiskuar.

6. Afati për vlerësimin do të jetë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga miratimi i urdhrin për vlerësim të ministrit përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore.

7. Ekspertët vlerësues hartojnë raportin përfundimtar të vlerësimit, bazuar në parashikimet e nenit 2, të ligjit nr. 66/2023, i cili përmban vlerën



minimale të shitjes, dhe ia përcjellin ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore.

8. Shpenzimet për ekspertët përballohen nga fondi i veçantë i objekteve të konfiskuara nga të ardhurat e siguruar nga shitja e objektit. Kjo pagesë do të jetë 2 (dy) % e vlerës së objektit apo të grup-objekteve të vlerësuar, por jo më pak se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, si dhe jo më shumë se 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

9. Shitja e objekteve të konfiskuara fillimisht u ofrohet subjekteve, që kanë të drejtën e parablerjes, pronari i truallit ose personat e tretë, sipas nënndarjeve “i” ose “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 66/2023. Nëse subjektet nuk shprehin interes, të drejtën e parablerjes e ka zhvilluesi/ndërtuesi, sipas procedurës së parashikuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 66/2023.

10. Struktura përgjegjëse për shitjen e pronës pranë ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronës shtetërore njofton me shkrim, për të drejtën e parablerjes, subjektet në lidhje me ushtrimin e kësaj të drejte.

11. Konfirmimi për ushtrimin e së drejtës së parablerjes nga subjektet bëhet me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, në lidhje me ushtrimin e së drejtës së parablerjes.

12. Në rastin e pronarit të truallit dhe të personave të tretë, e drejta e parablerjes realizohet sipas marrëveshjes juridiko-civile të hartuar para noterit, të regjistruar në regjistrat përkatës në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, përpara datës së konstatimit të paligjshmërisë së ndërtimit, të vërtetuar me faturë të bankave të nivelit të dytë.

13. Nëse personat e tretë nuk shfaqin interes për parablerjen, ata kompensohen për vlerën e paguar sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 66/2023. Kompensimi paguhet nga fondi i veçantë i objekteve të konfiskuara.

14. Pagesa e vlerës së objektit kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga konfirmimi me shkrim për ushtrimin e së drejtës së parablerjes, sipas pikës 11 të këtij vendimi. Në qoftë se subjekti nuk kryen pagesën brenda afatit, ai humbet të drejtën e blerjes së objektit të konfiskuar.

15. Në rast se pronarët e truallit, personat e tretë apo zhvilluesi/ndërtuesi nuk ushtrojnë të drejtën e parablerjes, shitja e objekteve të konfiskuara në tejkallim të lejes së ndërtimit do të kryhet në zbatim të kuadrit ligjor për ankandin publik. Procedurat e

kryerjes së ankandit publik bazohen në parimet e parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi për ankandin e pronave publike. Në asnjë rast nuk do të lejohet ofrimi i shitjes me një çmim më të ulët se vlera fillestare e ankandit publik.

16. Kontrata e kalimit të pronësisë nënshkruhet para noterit në format, si më poshtë vijon:

a) për pronarët e truallit dhe personat e tretë nënshkruhet kontratë për transferimin e të drejtave dhe të detyrimeve;

b) për zhvilluesin/ndërtuesin dhe ndaj blerësve, sipas procedurës së ankandit, nënshkruhet kontratë e shitjes.

17. Për nënshkrimin e kontratave, sipas pikës 16 të këtij vendimi, autorizohet drejtori i strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës.

18. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 646, datë 16.10.2024

**PËR PROCEDURËN DHE MËNYRËN E
PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË
AGJENCISË KOMBËTARE TË
KONTROLLIT TË CANNABIS-IT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr.61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ardhurat nga tarifa e lëshimit të licencës për subjektet aplikante derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

2. Të ardhurat nga tarifa vjetore mbi veprimtarinë e subjekteve të licencuara derdhen 70% në buxhetin e shtetit dhe 30% përdoren nga Agjencia.



3. Të ardhurat e Agjencisë, të krijuara sipas pikës 2, të këtij vendimi, klasifikohen në strukturën buxhetore me kapitull 06 “Të ardhura të veta jashtë limitit” të patrashëgueshme dhe përdoren vetëm për investime e shpenzime të mbarëvajtjes së veprimtarisë operacionale të Agjencisë.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis-it* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 647, datë 16.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 26, DATË 17.1.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020,

“Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 26, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2024”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Burime të tjera financimi për spitalet janë fondet e krijuara nga të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë së tyre dhe nga dhurimet, të cilat përdoren tërësisht nga vetë spitali. Përdorimi i të ardhurave dytësore miratohet nga bordi drejtues i spitaleve për spitalet që kanë përfituar autonominë menaxheriale. Për spitalet e tjera, përdorimi i të ardhurave bëhet bazuar në procedurat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto të ardhura vlerësohen si të ardhura jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës.”.

2. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 2
Buxheti për shërbimin spitalor

INSTITUCIONET	ARTIKUJT						TOTAL
	ART. 600	ART. 601	ART. 602	ART. 602 PPP LABORATORË	ART. 604	REZERVË	
QSR BERAT	403,250	68,820	182,407	63,750	0	0	718,227
BULQIZË	98,600	16,274	30,000	0	0	0	144,874
DELVINË	47,900	7,835	7,000	0	0	0	62,735
DEVOLL	60,670	10,050	12,000	0	0	0	82,720
DIBËR	344,100	55,715	135,000	32,650	0	0	567,465
ELBASAN	627,000	103,310	254,175	100,000	0	0	1,084,485
FIER	492,400	80,740	222,750	113,500	0	0	909,390
GRAMSH	153,460	25,080	35,000	0	0	0	213,540
GJIROKASTËR	291,400	46,910	120,000	35,450	0	0	493,760
HAS	58,297	9,720	16,000	0	0	0	84,017
KAVAJË	11,800	1,950	2,000	0	0	0	15,750
KOLONJË	98,990	15,920	20,000	0	0	0	134,910
KORÇË	556,870	91,770	295,000	83,000	0	0	1,026,640
KRUJË	157,900	26,015	32,000	0	0	0	215,915
KUÇOVË	44,190	7,011	17,593	0	0	0	68,794
KUKËS	337,170	55,560	126,000	36,230	0	0	554,960
KURBIN	114,190	19,070	37,000	0	0	0	170,260
LEZHË	346,090	56,140	190,000	64,450	0	0	656,680



LIBRAZHD	190,230	31,140	54,000	0	0	0	275,370
LUSHNJË	291,830	47,550	107,000	45,300	0	0	491,680
MALËSI E MADHE	29,800	4,795	6,600	0	0	0	41,195
MALLAKASTËR	53,710	8,775	13,000	0	0	0	75,485
MAT	170,850	27,695	40,000	0	0	0	238,545
MIRDITË	126,585	20,650	30,000	0	0	0	177,235
PEQIN	45,000	7,515	7,500	0	0	0	60,015
PËRMET	100,040	16,250	35,000	0	0	0	151,290
POGRADEÇ	222,200	36,215	84,000	0	0	0	342,415
PUKË	113,600	18,120	40,000	0	0	0	171,720
SARANDE	208,640	33,740	120,000	34,460	0	0	396,840
SKRAPAR	106,810	16,515	18,000	0	0	0	141,325
SHKODËR	717,320	117,540	383,650	65,900	0	0	1,284,410
TEPELENË	105,500	16,685	16,000	0	0	0	138,185
QSUT	3,448,600	557,780	4,872,184	781,765	0	0	9,660,329
SUOGJ "MBRETËRRESHA GERALDINË"	395,180	61,350	300,000	30,000	0	0	786,530
SUOGJ "KOÇO GLIOZHENI"	315,750	50,090	310,000	33,150	0	0	708,990
SU "SHEFQET NDROQI"	61,000	9,900	333,400	0	0	0	404,300
QSR "SHEFQET NDROQI"	595,380	95,150	450,000	102,700	0	0	1,243,230
SU TRAUMA	185,900	28,820	380,000	58,450	0	0	653,170
TROPOJË	134,150	21,885	40,000	0	0	0	196,035
VLORE	507,300	83,900	407,750	70,800	0	0	1,069,750
"MEMORIAL" FIER	0	0	0	0	1,092,824	0	1,092,824
DURRËS	0	0	0	76,300	1,243,100	0	1,319,400
Paketat e shërbimeve	0	0	0	0	1,622,686	0	1,622,686
Transferta për individët (mjekë specialistë)	0	0	0	0	30,000	0	30,000
Trajtime me VKM	0	0	0	0	30,000	0	30,000
Pagesat e shërbimeve PPP	0	0	0	0	2,676,104	0	2,676,104
Rezervë	0	0	0	22,145	0	130,465	152,610
TOTAL	12,369,652	2,009,950	9,782,009	1,850,000	6,694,714	130,465	32,836,790

VENDIM**Nr. 648, datë 16.10.2024**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË KRITEREVE QË NDIQEN PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE DHE
VEPRIMTARIVE NË FUSHËN E
TURIZMIT QË KONSIDEROHEN TË
RËNDËSISË SË VEÇANTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Miratimin e procedurave dhe të kriterëve që ndiqen për financimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit, referuar shkronjës "b", të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

2. Për të përfituar mbështetje financiare, projektet dhe veprimtaritë në fushën e turizmit duhet:

a) të jenë në përputhje me parimet e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në vend dhe politikat e ministrisë për zhvillimin e industrisë së turizmit;

b) të promovojnë industrinë e turizmit për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës;

c) të promovojnë produktet dhe destinacionet turistike, traditat dhe vlerat e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore të vendit;

ç) të promovojnë Shqipërinë në arenën ndërkombëtare, si një destinacion turistik holistik dhe të konsoliduar, me turizëm të qëndrueshëm, të diversifikuar dhe gjithëvjeter.

II. PROCEDURA PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE DHE VEPRIMTARIVE NË FUSHËN E TURIZMIT

1. Struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit, në ministrinë përgjegjëse për turizmin, përgatit informacion për iniciativën konkrete dhe, pas miratimit nga ministri përgjegjës për turizmin, ngrihet kolegji, sipas pikës 1, të nenit 31/1 të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, përgjegjës për ndjekjen e procedurave të vlerësimit dhe përzgjedhjes së subjekteve për lidhjen e kontratave:

a) me entitete kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë ekskluzivitetin për realizimin e projekteve dhe veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare në fushën e turizmit;

b) me subjekte që ofrojnë produkte dhe shërbime në funksion të projekteve dhe



veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare në fushën e turizmit.

2. Procedura për lidhjen e kontratave sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu, kryhet, si më poshtë vijon:

a) ministri përgjegjës për turizmin paraqet letrën e shprehjes së interesit për subjektin/ entitetin pritës së projektit/veprimtarisë;

b) struktura përgjegjëse për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit në ministrinë përgjegjëse për turizmin koordinon dhe zhvillon komunikimet për organizimin e përfaqësimit;

c) kolegji shqyrton propozimet e paraqitura dhe përzgjedh opsionin më të favorshëm, në aspektin e prezantimit, të cilin ia propozon për miratim ministrit;

ç) ministri apo personi i autorizuar prej tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përzgjedhja e opsionit më të favorshëm, lidh kontratën me subjektin apo filialet e autorizuar nga mbajtësi i së drejtës ekskluzive të projektit dhe/apo veprimtarisë;

d) pagesat për kontratat urdhërohen nga ministria përgjegjëse për turizmin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ekzekutohen nëpërmjet strukturës së thesarit.

3. Procedura për lidhjen e kontratave, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, kryhet, si më poshtë vijon:

a) ftesa për shprehje interesi, në përputhje me objektin e kontratës, u paraqitet të paktën tri subjekteve, të cilat duhet të shprehen zyrtarisht brenda 5 (pesë) ditëve nga data e ftesës;

b) struktura përgjegjëse për turizmin, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për prokurimin publik, hartojnë termat e referencës dhe përllogarisin fondin limit;

c) ftesa për propozim u paraqitet të paktën tri subjekteve, sipas afateve dhe kriterëve për kualifikim;

ç) afati për pranimin e propozimeve është 7 (shtatë) ditë nga data e ftesës për propozim;

d) kolegji, brenda 3 (tri) ditëve nga dorëzimi i propozimeve të paraqitura, vlerëson dokumentacionin dhe përzgjedh subjektin fitues, të cilin ia propozon për miratim ministrit;

dh) ministri apo personi i autorizuar prej tij lidh kontratën me subjektin e përzgjedhur brenda 3 (tri) ditëve nga njoftimi i fituesit.

III. KRITERET PËR KUALIFIKIMIN E SUBJEKTEVE QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR MBËSH-TETJE FINANCIARE

1. Subjekti, që i nënshtrohet procedurës së përzgjedhjes për mbështetje financiare, duhet të përmbushë këto kriterë kualifikimi:

a) të jetë i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të ketë status aktiv dhe të ketë përfshirë në fushën e veprimtarisë objektin e kontratës;

c) të mos ketë detyrime përmbaramore;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;

d) të ketë përmbushur detyrimet për pagimin e taksave, tatimeve dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) të ketë eksperiencë të ngjashme në fushën e kulturës, turizmit, argëtimit, promovimit, sipas portofolit të veprimtarive dhe aktiviteteve të realizuara ndër vite;

e) të vërtetojë kapacitetin teknik dhe profesional në proporcion me objektin e kontratës;

ë) të vërtetojë kapacitetin ekonomik dhe financiar në proporcion me objektin e kontratës.

2. Monitorimi i zbatimit të kontratave dhe realizimit të aktiviteteve kryhet nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të cilët përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 652, datë 16.10.2024****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

- Znj. Jehona Varfi emërohet drejtor i Circuit Kombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. (11-2024-2801) 823, datë 23.5.2024, vendosi heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Bujar Aruçi, i lindur më datë 29.9.1958, në Shijak, dhe banues në Maminas, Shijak, Durrës, me atësi Shaban dhe amësi Zoje, dhe vendosjen e tij në kujdestarinë ligjore të kërkuases Mejte Aruçi.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 882 (2998), datë 30.5.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Albin Roçi, i lindur më datë 28.10.2004, në Durrës dhe banues Durrës, me atësi Qazim dhe amësi Fatmire, dhe vendosjen e tij në kujdestarinë ligjore të kërkuases Fatmira Roçi.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 881 (11-2024-3000), datë 30.5.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ylber Hoxha, i lindur më datë 18.10.1981, në Durrës dhe banues në fshatin Shën Vlash, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, me atësi Fatmir dhe amësi Lavdije, dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuases Lavdije Hoxha.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 1124 (11-2024-4210), datë 15.7.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Yllka Mema, e lindur më datë 15.7.2003, në Tiranë, dhe banuese në Durrës, me atësi Frederik dhe amësi Florije, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të kërkuases Florije Mema.

KËRKESË

Shtetasja Raimonda Haxhiu kërkon pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë shpalljen të zhdukur të babait të saj, shtetasit Rebi Haxhiu, i datëlindjes 5.10.1931, lindur dhe banues në Tiranë.

KËRKUESE**Raimonda Haxhiu**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë